

**I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 3 (tre) vende pune për personel akademik me kohë të plotë pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike në Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë si më poshtë:**

**A. Kandidatët për personel akademik në kategorinë Lektor/Asistent-lektorë pranë Departamentit të Sistemeve Elektrike të Fuqisë në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të kenë përfunduar studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” ose studimet e ciklit 5-vjeçar në Inxhinieri Elektrike, drejtimi Energjitik;
2. Të kenë notë mesatare (ose të ponderuar) të studimeve Bachelor + Master i Shkencave ose të studimeve në ciklin 5-vjeçar mbi 8.0;
3. Të zotërojnë një gjuhë të huaj me dëshmi (preferohet anglisht);

**Kritere të tjera:**

4. Nota mesatare në lëndët matematikë, fizikë dhe elektroteknikë të jetë mbi 8.0;
5. Preferohet të kenë eksperiencë pune në sektorin elektroenergjitik;
6. Preferohet të kenë eksperiencë në mësimdhënie dhe aktivitet kërkimor shkencor në fushën përkatëse;
7. Preferohet të kenë qenë drejtues dhe pjesëmarrës në Projekte të ndryshme;
8. Të kenë aftësi komunikuese për transferimin e njohurive tek studentët;
9. Grada/Titulli përbën avantazh.

**B. Kandidatët për personel ndihmës akademik pranë Departamentit të Sistemeve Elektrike të Fuqisë në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Kandidatët të kenë përfunduar studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” ose studimet e ciklit 5-vjeçar në Inxhinieri Elektrike, drejtimi Energjitik;

**Kritere të tjera:**

2. Preferohet të kenë eksperiencë pune në sektorin elektroenergjitik;
3. Preferohet të zotërojnë një gjuhë të huaj (preferohet anglisht);
4. Preferohet të kenë eksperiencë në mësimdhënie dhe aktivitet kërkimor shkencor;
5. Të kenë aftësi komunikuese për transferimin e njohurive tek studentët.

**II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **03.02.2023** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.